<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të prezentojë dhe kuptojnë teorinë dhe praktikën e lojës në aspekte vijuese dhe të jet në gjendje të aplikojë këto principe me grupet e fëmijëve parashkollore;</li> <li>- Domethënia e lojës si fushë primare zhvillimore në fëmijëri të hershme;</li> <li>- Natyrën e lojës së lirë kreative;</li> <li>- Zhvillimin e lojës në vitet e fëmijërisë së hershme;</li> <li>- Roli i lojës në zhvillimin gjuhësor, përfshirë tranzicionin në të folur të brendëshme, aftësi komunikuese dhe negociuese;</li> <li>- Kuptimin e faktit se si loja mbështetë proceset sociale;</li> <li>- Njohuri praktike për aktivitetet që mbështesin vetëdijësimin shqisor;</li> <li>- Krijimi i mjedisit të mire për lojë të lire, materialet e duhura për mëshitetje të lojës.</li> </ul> <p>Më përfundimin e këtij trajnimi pjesëmarrësit do të kenë: zotërim të teorive dhe praktikës kryesore për lojën dhe të aplikoj ato në planifikim të situatave mësimore në parashkollore ;të ketë njohuri themelore mbi natyrën e lojës së lirë kreative përballë lojërave të strukturuar dhe aktiviteteve të dizajnuara për të rritur zhvillimin e fëmijëve ;të ketë zotërim themelor të fazave tipike të lojës dhe t'i identifikojë ato përmes observimit;të mund të identifikohen mënyrat përmes të cilave mbështeten dhe nxiten fushat e zhvillimit të fëmijëve në lojë;të përshkruaj mënyrat me të cilat loja nxitë marrdhëniet sociale;të krijoj një mjedis në të cilin fëmijët mund të luajnë të lirë;të shpjegoj prindërve përparësitë e zhvillimit të mësimin dhe fëmijëve përmes lojës.</p>

<b>Përmbajtja:</b>	<p>Programi i trajnimit (moduli) është përpjekur për të pajisur edukatorët parashkollorë me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që ato kanë nevojë në mënyrë që të zbatojnë programin mësimor parashkollor (në këtë rast në Kosovë) në klasat e tyre parashkollorë. Ky koncept është projektuar për përfituesit të cilët kanë nevojë për një trajnim në zhvillimin e vazhdueshëm profesional, në mënyrë që të zbatojnë programin parashkollor në qendrat/klasat e tyre.</p> <p>Ai përbëhet nga kurset e njohurive profesionale në mësimdhënie, njohuri në trren, zhvillimin e hershëm të fëmijëve dhe kulturës së përgjithshme. Trajnimi është përqendruar në zhvillimin profesional të edukatoreve parashkollorë dhe njohurit do të ofrohen gjatë një periudhe një javore (5 ditë) të trajnimit intenziv. Përfituesit do të mësojnë se si fëmijët mësojnë përmes lojës dhe metodave tjera të përshtatëshme metodike për moshat adekuate. Natyra e lojës si një aktivitet zhvillimor i rëndësishëm i fëmijëve në parashkollorë; fazat zhvillimore të lojës; roli i lojës në zhvillim gjuhësor; roli i lojës në zhvillim njohës; loja si mesatare për zhvillim të integruar shqisor; loja si mesatare për kompetenca sociale; parakushtet për mundësin e lojës së lirë kreative, përfshirë përdorimin e lodrave dhe lojës; integrimi i lojës në program</p>
<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi</b>	Po
<b>Data</b>	24.07.2014
<b>Nr. i trajnerve</b>	5

Titulli i programit	UDHËHEQJA DHE MENAXHIMI I SHKOLLAVE
Titulli i organizatës	GIZ
Tipi i programit:	Bazik
Ofertuesi i programit:	GIZ/MASHT
Adresa:	Rr. "Anton Çeta", nr.1, 10000, Prishtinë, Kosovë
E-mail:	<a href="mailto:Dagmar.fuchs-schmitz@giz.de">Dagmar.fuchs-schmitz@giz.de</a>
Telefoni:	+381 (0) 38 233 002
Numrat dhe data e akreditimit:	01/2010 18.10.2010
Kohëzgjatja e programit(orë)	164 orë
Përfituesit:	Drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulta
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është që të ofroj efikasitet dhe efektshmëri tek udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit në përgjithësi
Përmbajtja:	<p>Ekzistojnë 7 module dhe të gjitha modulet ndjekin të njëjtën strukturë: hyrjen, qëllimin e modulit si dhe përfundimin e pritur të modulit si pjesë e pare i cili ndiqet nga teksti kryesor ku prezantohen dhe shpjegohen konceptet, qasjet dhe instrumentet, duke përfshirë detyrat praktike për pjesëmarrësit. Pjesa përfundimtare e secilit modul përfshinë referencat dhe planifikimet si dhe shtojcat.</p> <p><b>Moduli 1: Cilësia e Arsimit</b>-Ky modul prezanton konceptin e cilësisë së arsimit në kontekstin ndërkombëtar dhe kombëtarë nënvizon marrëdhënien në mes të cilësisë së arsimit dhe rritjes ekonomike është nënvizuar gjithashtu edhe koncepti i monitorimit me bazë rezultatit dhe planifikimit me bazë të të dhënave.</p> <p><b>Moduli 2: Shkolla e mire</b>-Shpjegohen fushat cilësore për zhvillimin e shkollave, duke u fokusuar në kulturën e të mësuarit, kulturën e shkollës dhe nevojën për një strategji dhe vizion të zhvillimit të cilësisë në aspektin afatgjatë dhe afatmesëm.</p> <p><b>Moduli 3: Plani zhvillimor i shkollës</b>-Ky model ofron një qasje të strukturuar për të shtjelluar planin për zhvillim të shkollave. Formatu PZSH mbështet këtë proces duke ofruar një strukturë për hapat e njëpasnjëshëm që janë të nevojshëm për të identifikuar projektet primare për vitin e radhës.</p> <p><b>Moduli 4: Menaxhimi i projektit</b>-Prezantohen konceptet themelore në lidhje me projektin dhe menaxhmentin. Fazat e inicimit, planifikimit, ekzekutimit dhe vlerësimit të projektit shpjegohen në bazë të Menaxhimit të Ciklit të Projektit (PCM)</p> <p><b>Moduli 5: Komunikimi dhe Bashkëpunimi</b>-Komunikimi në një shkollë përshkruhet në detaje: me dhe në mes të arsimtarëve dhe prindërve. Janë prezantuar në baza ligjore, përbërja dhe roli i organizmave të ndryshëm të shkollës siç janë Këshilli dhe Bordi Menaxhues i shkollës.</p> <p><b>Moduli 6: Udhëheqësia dhe Administrimi i Personelit</b> –prezantohen disa lloje të udhëheqjes tema e delegimit shpjegohet në detaje. Për zhvillim sistematik të stafit, bazuar në vlerësim individual, shpjegohen për stafin jo-mësimor dhe mësimor.</p> <p><b>Moduli 7: Administrimi efektiv i shkollës dhe Udhëheqja e takimeve</b>-Moduli mbi administratën në shkollë fokusohet në menaxhimin e kohës, dokumenteve dhe takimeve.</p>
Metodat e realizimit të programit:	Të ndryshme
Certifikimi	Po
Trtajnert	4
Data	07/07.2010

Titulli i Programit	VETËDIJESIMI PËR ZJARRIN DHE TRAJNIMI I ZJARRFIKJES ME APARATE ZJARRFIKËSE
Titulli i organizatës	Tekniku sh.p.k QENDRA E AFTËSIMIT PROFESIONAL PËR MBROJTJE NGA ZJARRI DHE SIGURIA NË PUNË
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	QAMZ
Adresa:	Rr. "Aleksandër Mojsiu", 8/9, 50000 Gjakovë
E-mail:	<a href="mailto:info@tekniku.net">info@tekniku.net</a>
Telefoni:	044/122927
Numrat dhe data e akreditimit:	48/12 Pranohet për 2 vite 10.02.2012
Kohëzgjatja e programit (orë)	8 orë
Përfituesit:	Të gjithë mësimdhënësit
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30 persona maksimumi/për sesion trajnimi
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Me përfundimin e këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë të aftë të luftojnë zjarrin në ambientet e tyre të punës dhe të mbrojnë veten dhe të tjerët në organizata nga zjarri. Po ashtu do të jenë të aftë të përdorin aparatet zjarrfikëse me materie të ndryshme varësisht nga llojet e zjarreve që u kanosen.</p> <p>Objektivi kryesor i trajnimit është mbrojtja e shëndetit të punësuarve, mbrojtja e objekteve dhe pasurisë nga zjarri.</p> <p>Me përfundimin e këtij trajnimi pjesëmarrësit duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Njohin obligimit e tyre ligjore</li> <li>-Të jenë në gjendje të kuptojnë rëndësin e evakuimit efektiv</li> <li>-Të dinë se si ta parandalojnë një zjarr dhe limitojnë përhapjen e tij.</li> <li>-Përdorimin e rregullt të aparateve zjarrfikëse</li> </ul>
Përmbajtja:	<p>Programi i këtij trajnimi në pika të shkurtuara përmbajnë- Vuarja në dijeni për zjarrin</p> <p>Si shkaktohet zjarri, demet nga zjarret, pasojat e zjarrit për njerëz dhe pronë.</p> <p>-Elementet e zjarrit:</p> <p>Evakuimi i personave në rast zjarri në objekt, mbrojtja nga përhapja e zjarreve, materiet toksike që lirohen nga zjarret dhe mbrojtja nga to</p> <p>-Përzgjedhja aparateve zjarrfikëse:</p> <p>Konform llojeve të zjarreve, materiet zjarrfikëse dhe efekti i tyre në kategoritë e veçanta të zjarreve.</p> <p>-Vërja në funksion e aparateve zjarrfikëse, përdorimi i tyre :</p> <p>Pjesët përbërëse të aparateve zjarrfikëse, materiet zjarrfikëse dhe funksionimi i tyre.</p> <p>-Pjesa praktike e përdorimit të aparateve zjarrfikëse:</p> <p>Përdorimi i aparateve zjarrfikëse në zjarre reale sipas kategorive të ndryshme të zjarreve dhe materie të ndryshme të aparateve zjarrfikëse.</p> <p>-Legjislacioni në fuqi në aspektin e mbrojtjes nga zjarri dhe sigurisë në punë.</p>
Metodat e realizimit të programit	Në fund të trajnimit një ditë do të bëhet testimi me shkrim i kandidatit me pyetjet e përmbledhura nga ligjëratat, po ashtu do të bëhet testimi praktik i njohurive të marra me përdorimin real të pajisjeve.
Certifikimi:	Po
Data	14./12.2011
Trajnerë:	2



<b>Titulli i programit</b>	<b>VLERËSIM PËR NXËNIE (VPN); PROGRAM TRAJNIMI</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	<b>USAID\MASHT\QAK</b>
<b>Tipi i programit:</b>	<b>Bazik</b>
<b>Ofertuesi i programit:</b>	<b>MASHT\QAK</b>
<b>Adresa:</b>	<b>Kompleksi i shkollës "Mileniumi i tretë", rr. "Isa Kastrati", p.n.</b>
<b>E-mail:</b>	<b><a href="mailto:bepinfo@fhi360.org">bepinfo@fhi360.org</a></b>
<b>Telefoni:</b>	<b>038 258 301</b>
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	49/12 Akreditohet për 2 vite 26.03/2012
<b>Kohëzgjatja e programit(orë)</b>	20 orë 15 vijueshmëri 5 orë zbatimi
<b>Përfituesit:</b>	Nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulta: mësimdhënës, drejtorë, prindër dhe komuniteti i gjerë.
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	25-30 pjesëmarrës
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<p><b>Qëllimet e kursit</b></p> <p>Programi Vlerësimi për Nxënie-VpN që zhvillohet në kuadër të komponentës "Përmirësimi i vlerësimit të rezultateve të nxënësve" ka për qëllim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillojë vetëdijësimin e mësimdhënësve për rëndësinë e vlerësimit në nivel shkollë (VNSH)</li> <li>• Aftësojë mësimdhënësit për zbatimin e metodave të ndryshme të vlerësimit për qëllime të ndryshme</li> <li>• Të përmirësojë rezultatet mësimore në shkollat fillore dhe në ato të mesme të ulta.</li> <li>• Bashkëpunojë me MASHT-in për të hartuar standardet e vlerësimit dhe kodin e etikës për vlerësim.</li> </ul> <p><b>Rezultatet e të nxënësve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pas përfundimit të kursit vijuesit do të jenë në gjendje të:</li> <li>• Dallojnë Vlerësimin për Nxënie (VpN) dhe Vlerësimin e të nxënësve (ViN) dhe të identifikojnë karakteristikat e VpN-së. Të përshtatin strategjitë e mësimdhënies me karakteristikat e VpN-së.</li> <li>- Përcaktojnë dhe komunikojnë Qëllimin e të Nxënësve si dhe Kriteret e Suksesit si bazë e mësimdhënës i vlerësimit të ndërsjelltë edhe vetëvlerësimit.</li> <li>- Të shqyrtojnë llojet e pyetjeve të cilat janë në funksion të VpN-së</li> <li>- Të identifikojnë pyetjet sipas nivelit të vështirësisë si dhe të parashatrojnë pyetje sipas niveleve të ndryshme të menduarit .</li> <li>- Shqyrtojnë teknikat e vlerësimit të ndërsjelltë, të përcaktojnë rregullat për zbatimin e vlerësimit të ndërsjelltë si dhe të krijojnë rubrika për vlerësimin për nxënie.</li> <li>- Të hartojnë plane mësimore duke integruar Vlerësimin për Nxënie si pjesë e mësimdhënies së tyre të përditshme.</li> </ul>

Programi Vlerësimi për Nxënie (VpN) shqyrton aspekte të lidhura me vlerësimin dhe strategjitë e vlerësimit duke i gërshetuar ato me aktivitete praktike që mbështesin proceset e të nxënit. Programi në fjalë është i lidhur ngushtë me Standardet e Vlerësimit, që janë bazë e organizimit të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit në përgjithësi.

Vlerësimi formativ (Vlerësimi për Nxënie) dhe vlerësimi përmbledhës (Vlerësimi i Nxënies) janë koncepte bazë që përfshihen në programin në fjalë. Ndërkaq, shqyrtimi dhe analiza e karakteristikave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të vlerësimit për nxënie e përcjellin pjesën më të madhe të programit.

#### Shtatë strategjitë e vlerësimit për nxënie:

- 1.Qëllimi i të nxënit
- 2.Kriteret e suksesit
- 3.Parashtrimi i pyetjeve efektive
- 4.Informata kthyesë
- 5.Vlerësimi i ndërsjelltë
- 6.Vetëvlerësimi si dhe
- 7.Planifikimi i orës mësimore

#### Përmbajtja:

Në përgjithësi, programi shqyrton Vlerësimin për Nxënie (VpN) si një proces të vëzhgimit sistematik që siguron një kuptim më të mirë të asaj se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe si do të angazhohen ata thellësisht në procesin e të nxënit për të përmirësuar të arriturat e tyre në mënyrë të vazhdueshme.

Programi i Vlerësimit për Nxënie (VpN) shqyrton aspekte teorike të lidhura me vlerësimin dhe strategjitë e vlerësimit duke i gërshetuar ato me aktivitete praktike që mbështesin proceset e të nxënit. Programi në fjalë është i lidhur ngushtë me Standardet e Vlerësimit, që janë bazë e organizimit të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit në përgjithësi.

Vlerësimi formativ (Vlerësimi për Nxënie) dhe Vlerësimi përmbledhës (Vlerësimi i Nxënies) janë konceptet bazë që përfshihen në programin në fjalë.

Ndëkaq, shqyrtimi dhe analiza e karakteristikave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të vlerësimit për nxënie e përcjellin pjesën më të madhe të programit. Qëllimi i të nxënit dhe kriteret e suksesit, strategjitë për parashtrimin e pyetjeve, vlerësimi i ndërsjelltë dhe vetëvlerësimi janë çështjet kryesore që shqyrtohen në këtë program. Një prej sfidave që garanton cilësi të mësimdhënies dhe të nxënit është padyshim, planifikimi i orës mësimore, prandaj integrimi i VpN-së në planet e përditshme të mësimdhënësve paraqet një aspekt të rëndësishëm të këtij programi.

Në përgjithësi, programi shqyrton Vlerësimin për Nxënie (VpN)si një proces të vëzhgimit sistematik që siguron një kuptim më të mirë të asaj se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe si do të angazhohen ata thellësisht në procesin e të nxënit për të përmirësuar të arriturat e tyre në mënyrë të vazhdueshme.

<b>Metodat e realizimit të programit</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi</b>	Po
<b>Data e aplikimit</b>	31.01.2012
<b>Trajner</b>	18

<b>Titulli i programit</b>	<b>VËSHIRËSITË NË SJELLJE DHE EMOCIONE TË NXËNËSVE NË SHKOLLË DHE MENAXHIMI I TYRE, NGACMIMI DHE PARANDALIMI I NGACMIMIT</b>
<b>Organizatës</b>	EduCluster Finlandë Ltd
<b>Tipi i programit:</b>	Mbështetja për sistemin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë 2011-2013 Bazik
<b>Ofertuesi i programit:</b>	MASHT
<b>Adresa:</b>	Rruga: "Agim Ramadani", p.n., 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:sade.osmani@educlusterfinland.fi">sade.osmani@educlusterfinland.fi</a>
<b>Telefoni:</b>	0037744529823
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	61/12 29.08. 2012; Akreditohet për 2 vite
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	28 orë
<b>Përfituesit:</b>	Arsimtarët e shkollave fillore, të mesme të ulëta, shkollave të mesme të larta
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	20-25 pjesëmarrës
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në fund të trajnimit, arsimtarët janë të aftë të identifikojnë se cilat janë vështirësitë në sjellje dhe emocione të nxënësve, faktorët që ndikojnë në këto vështirësi, të kuptojnë më shumë për rëndësinë që kanë qëndrimet pozitive të mësimdhënësve në punë me këta nxënës, zhvillojnë shkathtësi të mësimdhënies përmes përdorimit të strategjive të ndryshme për menaxhimin e këtyre vështirësive.</li> <li>- Mësimdhënësit janë më të aftë të kuptojnë llojet e ngacmimit në klasë dhe shkollë dhe të njoftohen në mënyrat e parandalimit dhe luftimit të gjitha llojeve të ngacmimit në nivel individual, në nivel të shkollës.</li> </ul>
<b>Përmbajtja:</b>	<p>Vështirësitë në sjellje dhe emocione –identifikimi i tyre në klasë Faktorët që ndikojnë në vështirësitë në sjellje dhe emocione tek nxënësit Mungesa e vëmendjes, hiperaktiviteti dhe impulsiviteti(ADHD) Sjelljet e papërshtatshme të nxënësve Sjelljet agresive të nxënësve Llojet e ngacmimit në klasë dhe shkollë dhe format e parandalimit dhe luftimit të ngacmimit në nivel individual, në nivel të klasës dhe në nivel shkollë Vështirësitë emocionale Qëndrimet dhe shkathtësitë e mësimdhënies në punë me këta nxënës Shkathtësitë e këshillimit Bashkëpunimi me prindër dhe profesionistë tjerë me rëndësi për punë me këta fëmijë</p>
<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi:</b>	Po
<b>Data:</b>	22.05.2012
<b>Trajner:</b>	2

<b>Titulli i Programit</b>	<b>VËZHIMI DHE PËRDORIMI I TIJ NË VLERËSIMIN E FËMIJËVE NË ARSIMIN PARASHKOLLORË 0-3; MODULI PËR EDUKATORËT QË PUNOJNË ME FËMIJËT 0-3 VJEÇ</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	Save the Children International
<b>Tipi i programit:</b>	Plotësues
<b>Ofertuesi i programit:</b>	Save the Children International
<b>Adresa:</b>	Rr. "Gazmend Zajmi" Nr. 1, 10000 Prishtinë, Kosovë
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:scik@savethechildren.org">scik@savethechildren.org</a>
<b>Telefoni:</b>	+38138232691
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	167/16 26.09.2016
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	2016/2017
<b>Përfituesit:</b>	Edukatorët e arsimit parashkollorë që punojnë me fëmijët e moshës 0-3 vjeç
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	20-25 pjesëmarrës
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të nxitën edukatorët të njohin vëzhgimin si teknikë pune dhe ta përdorin atë në mënyrë të qëllimshme duke iu përgjigjur pyetjeve pse duhet të vëzhgoj? Çfarë të vëzhgoj? Çfarë instrumenti të përdorë dhe si ta përshtatë? Si t'i përdorë rezultatet e vëzhgimit për të përmirësuar punën me fëmijët në klasë?</li> <li>- 2.Të njihen me llojet e ndryshme të vlerësimeve, të cilat vëzhgimin e kanë teknikën bazë të tyre;</li> <li>- 3.Tu prezantohen shembuj instrumentesh vëzhgimi të përdorshme në grup moshën 0-3 vjeç;</li> </ul>
<b>Përmbajtja:</b>	<p>Modeli i trajnimit "Vëzhgimi dhe përdorimi i tij në vlerësimin e fëmijëve në arsimin parashkollorë 0-3" është përgatitur për edukatorët që punojnë me fëmijët e kësaj grup moshe në çerdhe. Ky material synon t'u jap edukatorëve një këndvështrim të thelluar mbi teknikën e vëzhgimit të fëmijëve, duke e futur atë në kontekstin e vlerësimit të arritjeve dhe progresit të fëmijës, apo të planifikimit.</p> <p>Në vend që tu jap instrumente të gatshëm vëzhgimi në mënyrë të qëllimshme. Moduli i prezanton edukatorët me metodat kryesore të vlerësimit të fëmijëve në çerdhe, ku vëzhgimi është teknika më e përdorshme e vlerësimit, si dhe u jep shembuj instrumentesh vëzhgimi të cilat mund të përshtatën prej edukatorëve sipas nevojave për vëzhgim. Sipas këtij këndvështrimi, materiali do t'i nxisë edukatorët të jenë jo thjeshtë transferues informacionesh, por kërkues aktivë të problematikave në klasë dhe do t'u nxisë gjykimin për të dalë në konkluzione dhe rekomandime për të përmirësuar punën e tyre me fëmijë të veçantë apo me të gjithë fëmijët e grupit.</p> <p>Programi i trajnimit përfshinë 1 ditë trajnimi nga 8 orë: që do të thotë se çdo pjesëmarrës ka 8 orë trajnim direkt.</p>
<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikim:</b>	Po
<b>Data:</b>	22.09.2016

<b>Titulli i Programit</b>	<b>VËZHGIMI DHE PËRDORIMI I TIJ NË VLERËSIMIN E FËMIJËVE NË ARSIMIN PARASHKOLLORË 3-6; MODULI PËR EDUKATORËT QË PUNOJNË ME FËMIJËT 3-6 VJEÇ</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	Save the Children International
<b>Tipi i programit:</b>	Bazik
<b>Ofertuesi i programit:</b>	Save the Children International
<b>Adresa:</b>	Rr. "Gazmend Zajmi" Nr. 1, 10000 Prishtinë, Kosovë
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:scik@savethechildren.org">scik@savethechildren.org</a>
<b>Telefoni:</b>	+38138232691
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	167/16 26.09.2016
<b>Kohëzgjatja e programit(orë)</b>	40 orë
<b>Përfituesit:</b>	Përfitues janë: nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë dhe familjet e tyre, gjithashtu përfitim do të ketë edhe vetë shkolla pasi që do të zvogëloj problemet e mësimdhënies përmes adresimit të problemeve të tyre
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	25-30 pjesëmarrës
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndhimohet fëmija me vështirësi në të nxënë në mënyrë që të mund të ndjekë planë-programin e rregullt;</li> <li>- Planifikimin sistematik të edukimit ,mësimdhënies për fëmijët me vështirësi në të nxënë ;</li> <li>- Mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijëve me vështirësi në të nxënë në mësim;</li> <li>- Planifikimi dhe përgatitjen e fëmijës në vesh tersit në të nxënë për fazën e transicionit.</li> </ul>

Programi i trajnimit për hartimin e PIA-s është program i cili ka për bazë dokumentin pedagogjik i cili është hartuar nga MASHT –i dhe hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues dhe mbështetësit e fushave të ndryshme zhvillimore ka marr vendimin për arsim me nevoja të veçanta. PIA shërben për planifikimin sistematik të edukimit, mësimdhënies, për mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijës në mësim.

Programi i trajnimit ka për qëllim ti aftësojë mësimdhënësit e shkollave fillore për identifikimin e fëmijëve që kanë nevojë për PIA dhe të hartojnë PIA –n për të gjithë fëmijët që kanë vështirësi në të nxënë. Gjatë trajnimit mësimdhënësit do të marrin informata lidhur me:

- Kush duhet të ketë një PIA?
- Si ndërlidhet PIA me planë-programin e përgjithshëm ?
- Kush është përgjegjës për inicimin e PIA-s?
- Kush i organizon takimet për hartimin e PIA-s?
- Kush merr pjesë në takimet për hartimin e PIA-s?
- Sa shpesh duhet rishikuar një PIA-s?
- Kush duhet të plotësoj PIA-n?

#### Përmbajtja:

Programi i trajnimit gjithashtu një rëndësi të veçantë i kushton pjesëve përbërëse të PIA-s, siç janë:

- Pjesa administrative;
- Pjesa pedagogjike;
- Pjesa e tranzicionit.

Pjesa pedagogjike është pjesa thelbësore e dokumentit dhe i gjithë përqendrimi do të jetë në këtë pjesë pasi është pjesa më e rëndësishme e PIA-s .Në këtë pjesë jepen informata për gjendjen momentale të fëmijës, d.m.th aftësitë dhe shkathtësitë, prirjet, nevojat dhe përshkruhen qartë qëllimet dhe objektivat, metodat e punës, përshtatjet ,materialet e nevojshme për punë dhe mënyrat e vlerësimit të fëmijës.

Metodologjia e punës që realizohet përmes këtij programi trajnues është kryesisht përmes teknikave të mësimit aktiv, ligjëratave interaktive, shkëmbimit të përvojave të programit të suksesshëm dhe punës në grupe.

Programi i trajnimit përfshinë 4 ditë trajnimit nga 8 orë: që do të thotë se çdo pjesëmarrës ka 32 orë trajnim direkt dhe 8 orë punë praktike- çdo pjesëmarrës deri në fund të programit të trajnimit merr 40 orë trajnim.

<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi</b>	Po
<b>Data</b>	22.09.2016
<b>Trajnerë:</b>	5

<b>Titulli i programit</b>	<b>VËSHTËRSITË NË SHKRIM DHE LEXIM, METODAT ALTERNATIVE TË MËSIMDHËNIES PËR TË PËRMIRËSUAR SHKATHTËSITË E LEXIMIT DHE SHKRIMIT DHE KRIJIMI I MATERIALEVE PËR TË MBËSHTETUR NXËNËSIT QË KANË VËSHTËRSI NË LEXIM DHE SHKRIM</b>	
<b>Titulli i organizates</b>	EDUCLUSTER Finland LTD	
<b>Tipi i programit:</b>	Plotësues	
<b>Ofertuesi i programit:</b>	MASHT	
<b>Adresa:</b>	Rruga: "Agim Ramadani", p.n., 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:Sade.osmani@educlusterfinland.fi">Sade.osmani@educlusterfinland.fi</a>	
<b>Telefoni:</b>	0037744529823	
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	04/11 19.01.2011	Akreditohet për 2 vite
<b>Kokëzgjatja e programit (orë)</b>	77 orë	
<b>Përfituesit:</b>	Arsimtarët klasorë të rregullt, edukatorët e klasave para fillore, arsimtarët e klasave të bashkangjitura, arsimtarët gjithëpërfshirës.	
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	25-30 pjesëmarrës	
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkathtësitë dhe aftësitë e kufizuara në lexim dhe shkrim. Cilat janë karakteristikat e nxënësve që kanë këto vështërsi.</li> <li>- Vlerësimi i shkathtësive në lexim dhe shkrim. Identifikimi dhe vlerësimi individual. Si të përdoren instrumentet e vlerësimit individual dhe vlerësimet grupore të shkathtësive të leximit dhe shkrimit.</li> <li>- Interpretimi i rezultateve të testimit dhe planifikimi i intervenimeve në nivel shkolle, klase dhe individual dhe mbështetja e nxënësve për të tejkaluar këto vështërsi.</li> <li>- Metodot e mësimdhënies përmirsuese për të përmirësuar shkathtësitë e shkrim leximit për ata nxënës që kanë vështërsi.</li> <li>- Mënyra e krijimit të materialeve për të mbështetur mësimin e leximit dhe shkrimit të fëmijve që kanë vështërsi në shkrim dhe lexim.</li> </ul>	
<b>Përmbajtja:</b>	Arsimtarët dhe edukatorët pas trajnimit janë të aftë të përdorin instrumentet e vlerësimit individual dhe grupor të shkathtësive të leximit dhe shkrimit, të analizojnë dhe interpretojnë ato rezultate dhe të përdorin metoda alternative të mësimdhënies për nxënësit që kanë vështërsi në lexim dhe shkrim.	
<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme	
<b>Certifikimi:</b>	Po	
<b>Datë:</b>	15.1.2011	
<b>Trajner:</b>	4	

<b>Titulli i Programit</b>	<b>ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË MËSIMDHËNIES CILËSORE DHE NDËRVEPRIMET ME KURRIKULËN</b>	
<b>Titulli i organizates</b>	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (në bashkëpunim me projektin IPA 2009 për trajnimin e mësimitdhënësve të implementuar nga GIZ IS)	
<b>Tipi i programit:</b>	Bazik	
<b>Ofertuesi i programit:</b>	Fakulteti i Edukimit	
<b>Adresa:</b>	Rr. "Agim Ramadani, p.n., Prishtinë, Kosovë	
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:Ethem.ceku@uni-pr.edu">Ethem.ceku@uni-pr.edu</a>	
<b>Telefoni:</b>	038229201	
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	86/13	Akreditohet për 2 vite
	23.12.2013	
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	32 orë	
<b>Përfituesit:</b>	Mësimitdhënësit e nivelit para-universitar	
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	25-30 pjesëmarrës	
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptuarit e rëndësisë së zhvillimit të vazhdueshëm profesional, identifikimi i praktikës profesionale dhe parimet e praktikave të nxënies gjatë gjithë jetës</li> <li>- Të shqyrtuarit e rolit të mentorit ,procesit të mentorimit në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve</li> <li>- Të kuptuarat e teorive kryesore të nxënies ,mësimnxënies dhe mësimitdhënies ndërvepruese dhe zbatimin e strategjive mësimore me nxënës në qendër</li> <li>- Të kuptuarit e filozofisë dhe strategjisë së re të KKK dhe zbatimin e saj në praktikë</li> <li>- Të kuptuarat dhe të zbatuarit e qasjeve të reja të vlerësimit të nxënësve, ndryshimin midis vlerësimit formative e sumativ dhe zbatimi i metodave të ndryshme për zhvillimin e kompetencave</li> </ul>	



Programi është i konceptuar në pesë Module:

**Moduli 1: Të kuptuarat e zhvillimit të vazhdueshëm profesional**

**Moduli 2: Mentorimi i mësimdhënies**

**Moduli 3: Mësimdhënia dhe të nxënit**

**Moduli 4: Hyrja në menaxhimin e kurrikulës së re të Kosovës**

**Moduli 5: Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve**

Përmes modulit të parë të paraqitur më lartë (moduli I), zhvillohen aftësi e shkathtësi lidhur me zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Aty përshkruhet në detaje, nevoja për zhvillimin profesional, mundësitë e shkollës dhe të komunës për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Gjithashtu, ofrohen edhe modele për planifikimin individual të zhvillimit profesional si dhe adresohen aspektet e reflektimit dhe praktikës reflektive të mësimdhënësve.

Në modulën e dytë, ofrohen njohuri e zhvillohen shkathtësi për mentorimin, rendësinë e mentorimit, rolin e mentorit në zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Gjithashtu përmes aktiviteteve të parapara jepet mundësia për reflektim ndaj modeleve teorike e praktike të përdorura më shpesh në punën me mësimdhënës dhe marrëdhëniet mentoruese.

Në modulën e tretë, ofrohen mundësi për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive për një mësimdhënës cilësorë, ndërvepruese dhe një tranzicion të natyrshëm prej qasjes tradicionale në qasjen bashkëkohore –me nxënësin në qendër. Gjithashtu ofrohen edhe teori të ndryshme të të nxënit dhe strategji të llojllojshme ndërvepruese të mësimdhënies.

Në modulën e katërt ofrohen udhëzime mbi parimet kryesore të KKK, udhëzime për mësimdhënësit drejt një procesi të të menduarit të tyre, reflektimin mbi përvojën e tyre profesionale dhe ndërlidhjen e fushave mësimore, kompetencave dhe rezultateve të të nxënit.

Në modulën e pestë ofrohen mundësi për zhvillimin i shkathtësive për parimit e vlerësimit, metodat e vlerësimit, llojet e vlerësimit (formative, sumative). Përmes shembujve praktik, ofrohen metodës të llojllojshme të vlerësimit ,veçmas të vlerësimit formativ të cilat qojnë në zhvillimin e kompetencave të parapara të KKK.

**Ngarkesa për mësimdhënës:** Programi i ka gjithsej 143 orë pune për pesë modulet duke përfshirë kohën dhe angazhimin në punëtori, leximin dhe përpunimin e materialit, dhe realizimin e aktiviteteve pas punëtorisë sipas specifikimeve në modelin përkatës.

Detajet e orëve për secilin lloj të aktiviteteve për secilin lloj të aktiviteteve për secilin modul janë të elaboruara në modulet përkatëse më poshtë.

**Certifikatat:** do të lëshohen si certifikat e përfundimit të modulit përkatës (dhe jo program) dhe do të specifikohet numër i orëve të modulit përkatës dhe jo tërë programit.

#### Përmbajtja:

<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi:</b>	Po
<b>Trajner</b>	13
<b>Data</b>	<b>18.12.2013</b>

## PJESA E DYTË

Në pjesën e dytë janë paraqitur programet e akredituara të cilat kanë afat të akreditimit/  
njohjes prej vitit 2017 e tutje.

Titulli i Programit	APLIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË MËSIMDHËNIE DHE TË NXËNIT E GJUHËS ANGLEZE	
Titulli i organizatës	USAID\MASHT\Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)	
Tipi i programit:	Bazik	
Ofertuesi i programit:	MASHT\QAK	
Adresa:	Kompleksi i shkollës "Mileniumi i Tretë", rr."Isa Kastrati", p.n.	
E-mail:	<a href="mailto:office@kec-ks.org">office@kec-ks.org</a>	
Telefoni:	038/244257/ext.109	
Numrat dhe data e akreditimit:	108/14 06.06.2014	Riakreditohet për 5 vite
Kohëzgjatja e programit (orë)	32 orë	
Përfituesit:	Mësimdhënësit e gjuhës angleze në shkollat e mesme të ulëta dhe të larta të Kosovës	
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25-30 pjesëmarrës	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Qëllimi i kursit Qëllimi kryesor i këtij kusi është t'i ndihmojë mësimdhënësit në përdorimin e aplikacioneve të ndryshme të Teknologjisë Informative për përmirësim e mësimdhënësve dhe të nxënimit të gjuhës angleze në shkollat e Kosovës. Synimi përfundimtar i programit është të tregohen mënyra të shfrytëzimit të teknologjisë informative për të lehtësuar dhe avancuar përfitimin e gjuhës angleze.</p> <p>Rezultatet e pritura Në fund të kursit tre-ditor pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptojnë dhe të zbatojnë metodat dhe strategjitë më të fundit në mësimdhënien e Anglishtes si Gjuhë e Huaj (AGJH) me nxënësit e tyre në klasës</li> <li>- Të demonstrojnë të kuptuarat dhe përdorimin efektiv të aplikimeve të ndryshme të teknologjisë informative (TI) NË MËSIMDHËNIEN DHE TË NXËNIT e gjuhës angleze</li> <li>- Të përdorin më mirë dhe në mënyrë më kreative teknologjitë eksistuese (kompjuterët personal dhe laptopët) dhe ato të reja (siç janë flip kamerat) për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësim nxënien në klasat e tyre;</li> <li>- Të shfrytëzojnë burimet e ndryshme të bazuara në rrjet për ta lehtësuar rrjetëzimin dhe komunikimin re tyre në gjuhën angleze.</li> </ul>	

<b>Përmbajtja:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në këtë kurs duhet të shqyrtohen temat vijuese.</li> <li>• Competency Relevant Skills</li> <li>• Rëndësia e përdorimit të TIK në mësimdhënien dhe të nxënit e gjuhës angleze</li> <li>• Aktiviteti "World Café"</li> <li>• Web faqet,diktimi online</li> <li>• Praktikues reflektiv,Vlerësimi formative,Portfoliot,Dhënia dhe pranimi i informative kthyes</li> <li>• Videotregimi –shkrimi dhe filmimimi</li> <li>• Videtregimi</li> <li>• Vetëvlersimi dhe vlrësimi i ndërsjellë</li> <li>• Webquest-aplikacion softuerik</li> <li>• Përdorimi i "Xtranormal"</li> <li>• Prezentimi i implementimit të Planeve Mësimore</li> <li>• Softuer online</li> <li>• Rrjetet sociale</li> </ul>
<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi</b>	Po
<b>Data</b>	30.04.2014

<b>Titulli i programit</b>	<b>APLIKIMI I TIK-UT NË ARSIM PËR MËSIMDHËNËSIT</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	Projekti i BE-së Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, dhe e –mësimi në Arsim
<b>Tipi i programit:</b>	Bazik
<b>Ofertuesi i programit:</b>	KE-së\MASHT
<b>Adresa:</b>	Postale 10000
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:Argjendosmani@outlook.com">Argjendosmani@outlook.com</a>
<b>Telefoni:</b>	+38138211681.0037744273502
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	Data e Akreditimit: 14.04.2017, nr: 177/14 +
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	20 orë
<b>Përfituesit:</b>	Mësimdhënësit e të gjitha niveleve të arsimit, studentet e Fakultetit të Edukimit, punonjësit në Qendrat Didaktike, hartuesit e kurrikulës dhe librave, zyrtarët e arsimit dhe të gjithë ata që tregojnë interes për të përdorur metodologjinë moderne në mësimdhënie dhe nxënie.
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	16 pjesëmarrës

Programi i propozuar i trajnimit synon të arrij këto objektiva:

- Zhvillimi i ekspertizës lokale në aplikim të TIK-ut në arsim
- Zhvillim i kompetencave në përvojën me aplikimin e teknologjisë në arsim
- Stimulimi i inovacioneve në arsim, puna me novatorë dhe adoptuesit e hershëm

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit e programit do të jenë në gjendje të:

1. Definojnë dhe përshkruajnë e-mësimin, identifikojnë metodat, veprimtaritë, mjetet dhe burimet e nevojshme për zbatimin e tij të suksesshëm.
2. Diskutojnë përparësitë dhe dobësitë e e-mësimit në krahasim me metodat tradicionale.
3. Vlerësojnë rrethanat dhe potencialet për implementimin e e-mësimit në kontekstin e vet (organizimi, mësimdhënia dhe nxënia, teknologjia).
4. Përdorimi i teknologjisë në aplikimin efektiv të mësimdhënies dhe mundësimi i nxënies.
5. Zbatojnë në mënyrë efektive aplikacionet Zapiton, Thinklink, Quizlet, Kahoot dhe Padlet.
  - Gjej, vlerëso dhe zgjidh përmbajtjen nga internet që duhet të përfshihen në mësimin e tyre.
  - Të përgatisë dhe mbajë prezantime efektive duke përdorur pajisje prezantimi: projektor, tavolinë kompjuter ose laptop, laps laseri, telekomandë, wireless mouse për të prezantuar punimet e tyre të realizuara përmes aplikacioneve: Zapiton, Thinklink, Quizlet, Kahoot dhe Padlet.
  - Aplikon me sukses punimet publike të ofruara në kuadër të Open Education Resources (OER), me theks të veçantë në zbatim të aplikacioneve të përmendura.
  - Komunikon lidhje me internet duke përdorur disa mjete (e-mail, forumin online, bisedat në chat, Skype ose të ngjashme), të përgatit shembuj të përdorimit në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
  - Përdorim LMS në rolin e studentit dhe krahason zbatimin e tij duke përdorur vegla të tjera për administrimin, komunikimin dhe publikimin e materialeve mësimore.
  - Zhvillon disa shembuj të përmbajtjes digjitale: tekst, fletëllogaritëse (spreadshet), foto, audio, video.
  - Përdorin disa programe sociale (siç janë Flickr, wiki ose të ngjashme) dhe të diskutojnë përdorimin e tyre të mundshme në mësimdhënie dhe nxënie.
  - Zbatimi i dy metodave bashkëpunuese në online dhe ambient klasor (parapërgatitjet, prezantimi i anëtarëve, caktimin e roleve në grup, të finalizuar dhe të paraqesë rezultatet e punës së grupit).

**Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:**

**Përmbajtja:**

1. **Pjesa hyrëse-** Ndryshimet në arsim dhe më gjerë, e-mësimin di teknologji imperative, kompetencat e reja të mësimdhënësve në zbatim të TIK-ut në arsim dhe zbatimi i mundshëm në të gjitha nivelet duke përfshirë të gjitha lëndët shkollore, arsyet e implementimit të programit trajnues.
2. **Prezantimi-** Rëndësia e planifikimit dhe përgatitjes për paraqitje të mire prezantuese, logjika e përmbajtjeve, numri i pikave, shuma e tekstit, shënimet , bashkëpunimi përmes platformës modele dhe mënyra e dorëzimit të detyrave.

Aftësitë e prezantimit: Paraqitja dinamike, gjuhës dhe stilit të folurit, duke shpjeguar përmbajtjen, përdorimi i kujdesshëm i humorit, besueshmërisë, durimi, ndihma, aplikimi i burimeve të hapura dhe modifikimi i tyre për nevojat tona.

3. **Komunikimi-** E-mail, Forumi për ndihmë, Chat, Skype
4. **Krijimi-** Arsyet për krijimin e përmbajtjeve, përdorimi i mundshëm i përmbajtjeve, cilësia e mësimdhënies dhe nxënies si një objektiv për përdorimin e teknologjisë në arsim. Arritjen e cilësisë më të lartë përmes vizualizimit dhe interaktivitetit, përmirësimi i komunikimit, përfshirja, rritja e përgjegjësisë.
5. **Bashkëpunimi-** Tendencat dhe zhvillimet e reja në arsim (realiteti virtual, aplikimi i resurseve të hapura për arsim (OER), shpërndarja e materialeve didaktike, wiki, blog, aplikimi i veglave për krijim të përmbajtjeve elektronike (Quizlet, Kahoot, Thinklink, Playposit, google documents, etj).

<b>Metodat e realizimit të programit</b>	Ligjerata, punë ekipore, detyra dhe projekte.
<b>Certifikimi</b>	Po, vetëm për pjesëmarrësit e suksesshëm (pragu i kalueshmërisë 60%)
<b>Trajner</b>	12
<b>Data</b>	15.02.2017

<b>Titulli i programit</b>	<b>ECDL</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	<b><u>Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)</u></b>
<b>Tipi i programit:</b>	Bazik
<b>Ofertuesi i programit:</b>	SBASHK-u
<b>Adresa:</b>	<b><u>Rr. Agim Ramadani, p.n. Qendra e Studentëve – Drejtoria 10000 Prishtinë</u></b>
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:sbashk2004@yahoo.com">sbashk2004@yahoo.com</a>
<b>Telefoni:</b>	<b><u>+381 38 226 940</u></b>
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	13/2011 19.01.2011 Akreditohet për 2 vite
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	Programi ka gjithsej <b>120 orë</b> . <b>7 Module</b>
<b>Përfituesit:</b>	<b><u>Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)</u></b>
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	15-20 pjesmarrës
<b>QËLLIMI:</b>	Qëllimi i programit është ndërtimi i një sistemi efikas të aftësisë dhe njohjes së teknologjisë informative lidhur me përdorimin e kompjuterit, menaxhimit cilësor të zhvillimit profesional të mësimdhënësve përmes programeve më efikase që përmirësojnë kapacitetet profesionale në këtë fushë.
<b>OBJEKTIVAT:</b>	Zhvillimi dhe rritja e aftësive në njohjen e përdorimit të kompjuterit nga mësimdhënësit duke shfrytëzuar TI në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si dhe për zhvillimin profesional të mësimdhënësve për zbatimin e KKK/kurikulave .
<b>ÇËSHTJET RELEVANTE PËR PRIORITETET E MASHT-it:</b>	Projekti do të kontribuojë në arritjen e caktuar (ZHM 7) të përcaktuar me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016: <i>Deri në vitin 2016 90 % e mësimdhënësve e kanë ripërtërirë licencën , ndërsa 10% e tyre janë promovuar në një nivel më të lartë : promovimi të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Zhvillimi profesional i tyre. Për të implementuar kurrikulat për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, të shoqëruar me përmirësimet e nevojshme në metodologji të mësimdhënies, të të nxënësve dhe të vlerësimit të nxënësve.</i>
<b>REZULTATET E PROJEKTIT</b>	- Realizohet trajnimi për praktikën e mira të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, për zbatimin e kurrikulave dhe teknologjisë së informimit në programet arsimore;
<b>( REZULTATET E PRITURA):</b>	- Ngritët cilësia e trajnimeve për mësimdhënës për të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar; dhe  - Monitorohet dhe vlerësohet programi në fazat e ndryshme të zbatimit dhe certifikimit.



<b>PËRFITUESIT:</b>	<b>Shkollat dhe mësimdhënësit e arsimit parauniversitar.</b>
Projekti në vete përmban:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimin e trajnimit të ofruar për mësimdhënëës është i bazuar në standarde dhe licencë ndërkombëtare/ evropiane për njohje të kompjuterit .</li> <li>2. Certifikimi dhe vlerësimi është i bazuar në kritere dhe rezultate të cilësisë deri në 90% të rezultateve të arritura.</li> <li>3. Përmbajtja e moduleve për programin ekzistues të trajnimit të mësimdhënësve, të ketë për bazë të kompetencat dhe rezultatet që lidhen me procesin mësimor me këto module: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Konceptet e teknologjisë informative (TI) /Computer Essentials</li> <li>2. Procesimi i tekstit (Word) /Word processing (Advanced)</li> <li>3. Tabelat llogaritëse (Excel) /Advanced spreadsheets</li> <li>4. Baza e të dhënave (Acces)/Standard</li> <li>5. Prezentimet (Power point) /Advanced</li> <li>6. Bashkëpunimi në linjë/ Online collaboration</li> <li>7. Sigurimi në Teknologjinë informative/IT security</li> <li>8. Planifikimi i projekteve /Project planning</li> </ol> </li> </ol>
<b>Certifikimi :</b>	<b>Po</b>
<b>Data:</b>	19.01.2011
<b>Trajner:</b>	<b>20</b>

Titulli i programit	EDUKIMI MULTI DHE NDËRKULTUROR ETALON I PAQËS NË BOTË
Titulli i organizatës	Qendra për Avancim e Performancës së Arsimit-QAPA
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	QAPA
Adresa:	Rr. "Lidhja e Pejës", Zona Industriale, 10000 Prishtinë
E-mail:	<a href="mailto:info@qapa-ks.org">info@qapa-ks.org</a>
Telefoni:	038/601/510
Numrat dhe data e akreditimit:	120/2015 Organizata pranohet për 5 vite 16.01.2015
Kohëzgjatja e programit(orë)	40 orë
Përfituesit:	Drejtorët, bashkëpunëtorët profesionalë ,zyrtarët e arsimit ,mësimdhënësit dhe komuniteti i prindërve
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25-30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Pas përfundimit të trajnimit pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruajnë dhe shpjegojnë konceptet themelore që lidhën me :edukimin, arsimin, mësimdhënien dhe të nxëniet multi dhe ndërkulturore;</li> <li>- Argumentojnë pse Edukimi /Ndër/Kulturore-EMNK është mjet për themelor për ruajtjen e paqes në botë</li> <li>- Përcaktojnë qëllimet e EMNK</li> <li>- Identifikojnë burimet e ngjashmërisë dhe të diversiteti .</li> <li>- Përshkruajnë faktorët që shoqëritë i bënë multi dhe shumë kulturore</li> <li>- Argumentojnë se projekti për EMNK nuk është tradhti por atdhetari</li> <li>- Përshkruajnë zhvillimin historik të EMNK</li> <li>- Përshkruajnë dhe të argumentojnë bazën shkencore të EMNK</li> <li>- Përshkruajnë dhe të argumentojnë bazën shkencore të EMNK.</li> <li>- Përshkruajnë paketën e EMNK</li> </ul> </li> </ul>

<b>Përmbajtja:</b>	<p>1. Hyrje: Burimet e ngjashmërisë dhe të diversitetit; Kultura prodhon ndryshime dhe diversitete; Kush i bëri shoqëritë pluri/shumë-etnike dhe multi /shumë –kulturore; nëse është tradhti, nisja e një projekti shumë kulturor.</p> <p>2. Konceptet themelore dhe histori e shkurtë e Edukimit Multi /Ndër/ Kulturor: KONCEPTET THEMELORE; Zhvillimi historik i EMNK</p> <p>3.Baza shkencore e EMNK</p> <p>EMNK në sistemin e disiplinave shkencore; Qëllimi i EMNK; Dobët nga EMNK: Nga EMNK deri të integritit globale; EMNK dhe Arsimit cilësor për të gjithë</p> <p>4. Paketa e EMNK</p> <p>Përmbajtja e Paketës së EMNK; Edukimi dhe Arsimit cilësor për të gjithë, themel kryesor për EMNK; Baza juridike e EMNK; Edukimi për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut kolonë e EMNK; Edukimi për Paqe-Pedagogjia –edukolgjia e Paqes; Edukimi Multi /Ndër/Kulturor pjesë e pa ndarë e sistemit të arsimit ;Krijimi i institucioneve –shkollave multikulturore; Konceptet dhe karakteristikat më të thella kulturore; Zhvillimi i ndjeshmërisë për multikulturalitet dhe multietnicitet.</p>
<b>Metodat e realizimit të programit</b>	
<b>Certifikimi</b>	
<b>Datë</b>	15.01.2015
<b>Nr.i trajnerëve</b>	4

<b>Titulli i Programit</b>	<b>FASILITIMI I STANDARDEVE PËR KRYEFASILITUESIT E TË NXËNIT</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	USAID Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
<b>Tipi i programit:</b>	Bazik
<b>Ofertuesi i programit:</b>	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
<b>Adresa:</b>	Kompleksi i shkollës "Mileniumi i Tretë", rr."Isa Kastrati", p.n.
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:office@kec-ks.org">office@kec-ks.org</a>
<b>Telefoni:</b>	038/244257/ext.109
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	128/2015 Akreditohet për 5 vite 29.06 2015
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	24 orë
<b>Përfituesit:</b>	Përfituesit e drejtpërdrejtë –Fasilitatorët shkollorë Përfituesit tjerë-Të gjithë mësime dhënësit e shkollave fillore në vend.
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	20-25 pjesëmarrës
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<p><b>Pjesëmarrësit do të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrin njohuri për Standardet Fasilituese për Zhvillim profesional, si dhe për shkathtësitë e nevojshme për ta përmbushur rolin e kryefasilitatorit të të nxënit.</li> <li>- Marrin njohuri rreth sjelljeve dhe qasjeve të fasilitimit efektiv duke punuar në ekip me qëllim të përkrahjes së fasilitatorëve shkollorë.</li> <li>- Demonstrojnë rolin e tyre si Kryefasilitatorë dhe do të vlerësohen nga kolegët.</li> </ul>

Kursi në përmbajtjen e vet ka 8 tema dhe pjesën praktike përmes të cilave arrihen rezultatet e pritura:

**Përmbajtja:**

**1. Standardet e Lehtësimit të zhvillimit profesional**-Caktimi i objektivave të zhvillimit profesional .Të kuptuarit e standardeve dhe roli i Kryefasilitatorve si dhe Korniza e Certifikimit dhe praktikave të Kryefasilitatorëve të nxënës

**2. Ndikimi Shkathtësive Relevante** –Të kuptuarat e përparësive të shkathtësive relevante në kuadër të KK të Kosovës dhe BEP. Roli i kryefasilitatorit në mbështetje të zhvillimit të shkathtësive relevante tek të nxënësit.

**3. Barazia Gjinore dhe Fasilitimi**-Identifikimi dhe zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për të rritur vetëdijen për barazinë gjinore në aktivitetet e zhvillimit profesional.

**4. Dosja elektronike** –Hapja dhe mirëmbajtja e dosjes në formë elektronike në ueb, si vegël e zhvillimit profesional.

**5. Shkathtësitë dhe arti i të Dëgjuarit dhe të Pyeturit** –Identifikimi dhe të ushtruerit e shkathtësive konstruktive të dëgjuarit dhe të pyeturit, si dhe reflektimi mbi rolin e tyre në krijimin e një mjedisi të besueshëm dhe bashkëpunues.

**6. Puna ekipore dhe Zgjedhja e konflikteve** –Pjesëmarrja në aktivitete për krijimin e ekipit me qëllim të vlerësimit të kompleksitetit të punës ekipore dhe identifikimi dhe reflektimi i llojeve të zgjedhjeve të konflikteve.

**7. Mentorimi për praktika të mësimdhënies cilësore** –Të kuptuarat se si mentorimi mund të përmirësojë praktikën e mësimdhënies, sidomos për arritjen e caqeve të shkathtësive të BEP.

**8. Sesioni praktik dhe vlerësimi i pjesëmarrësve** –Çdo pjesëmarrës ka mundësi të përgatisë dhe të prezantoj /demonstrojnë në ekip një aktivitet, bazuar në Standardet e Fasilitimit për Zhvillim profesional të BEP-it.

Për tu certifikuar kandidati për Kryefasilitator, duhet të fasilitojë pjesën praktike gjatë zhvillimit të ndonjë kursi dhe të vlerësohet sipas Standardeve Fasilituese të Zhvillimit profesional .Praktika zgjat së paku dy seanca 90 minuteshë.

Pas vlerësimit të suksesshëm të fasilitimit të pjesës praktike, kryefasilitatori certifikohet me 24 orë trajnimi.

<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi:</b>	Po
<b>Trajner:</b>	11
<b>Data:</b>	15.05.2015

<b>Titulli i programit</b>	<b>FASILITIMI I STANDARDEVE TË TË NXËNIT</b>	
<b>Përfituesit e paraparë</b>	Trajnimi është përgatitur për udhëheqësit e shkollave (drejtorët/zv.drejtorët) në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Në trajnim, përveç drejtorëve/zv.drejtorëve të shkollave, përfshihen edhe koordinatorët e cilësisë, me qëllim qartësimin e rolëve në procesin e menaxhimit të cilësisë në shkollë dhe bashkimin e sinërgjive për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me procesin e menaxhimit të cilësisë në shkollë.
<b>Qëllimi, rezultatet e pritura ose objektivat e programit</b>	<p><b>Qëllimi:</b> Trajnimi ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të udhëheqësve të shkollave të Kosovës për mbështetjen, drejtimin, koordinimin dhe monitorimin e menaxhimit të cilësisë në nivel shkollë.</p> <p><b>Objektivat kryesore të trajnimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhim të cilësisë në nivelin e menaxhmentit të shkollës për të përmirësuar menaxhimin e cilësisë në shkolla, bazuar në ciklin e menaxhimit të cilësisë dhe në linjë me qasjen për zhvillimin e cilësisë në shkolla të specifikuar në Strategjinë për Sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë (MASHT, 2016).</li> <li>- Forcimi i konceptit të menaxhimit &amp; udhëheqëjes në harmoni me kontekstin ekzistues për udhëheqje, si dhe ndryshimi i paradigmës nga ajo lineare, në të menduar për sistemin, identifikimin e fushave për udhëheqje inovative,</li> <li>- Ndërtimi i një të kuptuari të përbashkët për aktivitetet dhe proceset e vlerësimit (vlerësimi i jashtëm dhe vlerësimi me bazë në shkollë, vet-vlerësimi) dhe familjarizimi me pakon e metodave dhe instrumenteve adekuate të vlerësimit për përdorim në procesin e menaxhimit të cilësisë në shkollë,</li> <li>- Ndërtimi i kulturës për reflektim kolegjial dhe vet-reflektim, si bazë për menaxhimin e cilësisë dhe zhvillimin e shkollës.</li> </ul> <p><b>Rezultatet kryesore:</b></p> <p>Pjesëmarrësit e trajnimit janë të kualifikuar në zbatimin, mbështetjen dhe drejtimin e proceseve për menaxhimin e cilësisë në shkollat e tyre me profesionalizëm në:</p>

- Planifikim, zbatim dhe monitorim të proceseve të menaxhimit të cilësisë së shkollës, në koordinim me koordinatorin për menaxhimin e cilësisë me bazë në shkollë,
- Dizajnimin e Planit Zhvillimor të Shkollës dhe Planit të Vjetor të Veprimit,
- Informimin e mësimdhënësve lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e cilësisë në shkollë,
- Inkurajimin dhe mbështetjen e mësimdhënësve në aktivitetet e menaxhimit të cilësisë,
- Inicimin, koordinimin dhe drejtimin e projekteve dhe proceseve për zbatimin e masave të zhvillimit të cilësisë, në bashkëpunim me koordinatorin e cilësisë së shkollës dhe personelin e shkollës,
- Forcimin e planifikimit, organizimit dhe zbatimit të aktiviteteve të vet-vlerësimit, me qëllim të reflektimit në progresin e zhvillimit dhe arritjeve në fushat e cilësisë së shkollës,
- Udhëheqjen dhe motivimin e personelit të shkollës që të punojë sipas ciklit të menaxhimit të cilësisë Planifiko-Bëj-Kontrolli-Vepro,
- Analizimin dhe interpretimin e rezultateve të vetë-vlerësimit,
- Raportimin për menaxhimin e cilësisë dhe rezultatet e tij tek anëtarët e personelit, DKA-të dhe MASHT-i, brenda kornizës së pajtuar dhe të ndarë bashkërisht,

Programi i trajnimit sipas ditëve ka përmbajtjen në vijim:

#### **DITA E PARË**

- Hyrje në trajnim - njoftimi me qëllimin dhe programin e trajnimit, planin e trajnimit, njoftimi i pjesëmarrës dhe rregullat e trajnimit
- 

#### **Sesioni 1. Sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë**

- Strategjia për Sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë
- Ndryshimet në legjislacionin arsimor
- Trendet internacionale në sigurimin e cilësisë
- Ndryshimi i fokusit në rezultate të të nxënësve – Korniza e re Kurrikulare,
- Ndërlidhja në mes të vlerësimit të brendshëm (vetvlerësimit) dhe vlerësimit të jashtëm,
- Elementi thelbësor për sigurim të cilësisë: cikli "Planifiko-Bej-Kontrollo-Vepro"

#### **Sesioni 2. Të kuptuarit e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë**

- Definimi i koncepteve: **Cilësi dhe Sigurim i cilësisë,**
- Sigurimi i cilësisë – përgjegjësi e ndarë në niveleve të ndryshme arsimore
- Parimet e udhëheqjes për sigurimin e cilësisë në shkolla

#### **Sesioni 3. Procesi i sigurimit të cilësisë në shkolla**

- Fazat dhe llojet e proceseve të sigurimit të cilësisë
- Korniza për sigurimin e cilësisë – fushat e cilësisë dhe kriteret
- Vlerësimi i performancës së shkollës – Vlerësimi i brendshëm (vetvlerësimi)

#### **Sesioni 4. Procesi i menaxhimit të sigurimit të cilësisë në shkolla**

- Cikli i procesit të menaxhimit të cilësisë PBKV dhe ndërlidhja e PZSHH dhe PV të shkollave

#### **Përmbajtja e programit**

**DITA E DYTË****Sesion 1. Cikli i procesiot të menaxhimit të cilësisë**

- Hap i parë: PLANIFIKO
- Hap i dytë: BËJ
- Hap i tretë: KONTROLLO
- Hap i katërt: VEPRO

**Sesioni 2. Menaxhimi i përmirësimit të vazhdueshëm**

- Procesi përgatitor
- Procesi i Vetëvlerësimit
- Procesi i planifikimit të përmirësimit të vazhdueshëm

**Sesioni 3. Rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e cilësisë në shkollë**

- Detyrat me rëndësi për menaxhimin e cilësisë në shkollë
- Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive për akterët e përfshirë në menaxhimin e cilësisë në shkollë

**Sesioni 4. Zhvillimi i kulturës së reflektimit**

- Format e reflektimit
- Pse duhet ta bëjmë? Kush duhet të përfshihet? Si duhet ta bëjmë/ fillojmë atë?
- Ndikimi në menaxhimin e ndryshimit.
- Detyrat praktike, të cilat duhet të realizohen nga pjesëmarrësit deri në ditën e tretë të trajnimit,
- Orari i mentorimit

**Mentorimi në grupe prej 4-5 pjesëmarrës****Përmbajtja e trajnimit për ditën e tretë****SESIONI 1. Prezantimi i detyrave praktike**

- Shembuj të praktikave të mira
- Reflektim dhe diskutim për punën praktike (detyrat) dhe rezultatet e tyre
- Informacione teorike shtesë për çështjet e diskutuara (gjatë trajnimit)

**SESIONI 4. Zhvillimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve për menaxhim të cilësisë në shkollë**

- Informim për mundësitë për zhvillim të mëtutjeshëm profesional për menaxhimin e cilësisë në shkollë
- Reflektim rreth programit të trajnimit, mësimet e marra
- Informacion kthyes

<b>Metodat e realizimit të programit</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi</b>	Po
<b>Data</b>	26.04.2017

<b>Titulli i Programit</b>	<b>TRAJNIMI PËR MËSIMDHËNËS NË OFRIMIN E NJËSIVE MËSIMORE NGA MANUALI DIDAKTIK PËR PARANDALIMIN E DHUNËS</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	Save the Children International
<b>Tipi i programit:</b>	Plotësues
<b>Ofertuesi i programit:</b>	Save the Children Internacional
<b>Adresa:</b>	Rr." Gazmend Zajmi", Nr. 1, 10000 Prishtinë, Kosovë
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:scik@savethechildren.org">scik@savethechildren.org</a>
<b>Telefoni:</b>	+38138232691
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	141/2015 akreditohet për 3 vite 21.12.2015
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	24 orë
<b>Përfituesit:</b>	Përfitues janë: nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë dhe familjet e tyre, gjithashtu përfitim do të ketë edhe vetë shkolla pasi që do të zvogëlojë problemet e mësimdhënies përmes adresimit të problemeve të tyre
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	25 pjesëmarrë
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndhimohet fëmija me vështirësi në të nxënë në mënyrë që të mundtë ndjek plan-programin e rregullt;</li> <li>- Planifikimin sistematik të edukimit ,mësimdhënies për fëmijët me vështirësi në të nxënë ;</li> <li>- Mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijëve me vështirësi në të nxënë në mësim;</li> <li>- Planifikimi dhe përgatitjen e fëmijës në vesh tersit në të nxënë për fazën e transicionit.</li> </ul>

Programi i trajnimit për hartimin e PIAS-s është program i cili e ka për bazë dokumentin pedagogjik i cili është hartuar nga MASHT –i dhe hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues dhe mbështetësit e fushave të ndryshme zhvillimore ka marr vendimin për arsim me nevoja të veçanta. PIA shërben për planifikimin sistematik të edukimit, mësimdhënies, për mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijës në mësim.

Programi i trajnimit ka për qëllim t'i aftësojë mësimdhënësit e shkollave fillore për identifikimin e fëmijëve që kanë nevojë për PIA dhe të hartojnë PIA –n për të gjithë fëmijët që kanë vështirësi në të nxënë .Gjatë trajnimit mësimdhënësit do të marrin informata lidhur me:

- Kush duhet të ketë një PIA?
- Si ndëlidhet PIA me plan-programin e përgjithshëm ?
- Kush është përgjegjës për iniciimin e PIA-s?
- Kush i organizon takimet për hartimin e PIA-s?
- Kush merr pjesë në takimet për hartimin e PIA-s?
- Sa shpesh duhet rishikuar një PIA-s?
- Kush duhet të plotësoj PIA-n?

**Përmbajtja:**

Programi i trajnimit gjithashtu një rëndësi të veçantë i kushton pjesëve përbërëse të PIA-s, siç janë:

- Pjesen administrative;
- Pjasa pedagogjike;
- Pjesa e tranzicionit.

Pjesa pedagogjike është pjesa thelbësore e dokumentit dhe i gjithë përqendrimi do të jetë në këtë pjesë pasi është pjesa më e rëndësishme e PIA-s .Në këtë pjesë jepen informata për gjendjen momentale të fëmijës, d.m.th aftësitë dhe shkathtësitë, prirjet, nevojat dhe përshkruhen qartë qëllimet dhe objektivat, metodat e punës, përshtatjet, materialet e nevojshme për punë dhe mënyrat e vlerësimit të fëmijës.

Metodologjia e punës që realizohet për mes këtij programi trajnues është kryesisht përmes teknikave të mësimit aktiv, ligjëratave interaktive, shkëmbimit të përvojave të programit të suksesshëm dhe punës në grupe. Programi i trajnimit përfshinë 4 ditë trajnimi nga 8 orë: që do të thotë se çdo pjesëmarrës ka 32 orë trajnim direkt dhe 8 orë punë praktike- çdo pjesëmarrës deri në fund të programit të trajnimit merr 40 orë trajnim.

<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi:</b>	Po
<b>Data:</b>	22.09.2015



Titulli i Programit	TRAJNIMI PËR MËSIMDHËNËSIT MENTORË
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit /Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsimin – IHZHA
Tipi i programit:	Bazik
Trajner	Mësimdhënësit nga Fakulteti i Edukimit
Adresa:	Rr."Agim Ramadani", p.n., Prishtinë, Kosovë
E-mail:	<a href="mailto:ethem.cekuni@uni-pr.edu">ethem.cekuni@uni-pr.edu</a>
Telefoni:	038229201
Grupi i synuar	Mësimdhënësit e sistemit arsimor para universitar –potencial për mentorë
Qëllimi i trajnimit	Të kuptuarit e procesit të monitorimit dhe keq për udhëheqje dhe mbikëqyrjeje të studentëve të FAKULTETIT TË EDUKIMIT NË PRAKTIKËN SHKOLLORE
Numrat dhe data e akreditimit:	178/17 14.04.2017 Akreditohet për 1 vit
Kohëzgjatja e programit orë)	24 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e sistemit arsimor para universitar –potencial për mentorë
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Pjesëmarrësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillojnë shkathtësi të mentoritit</li> <li>- Shpjegojnë rolet dhe përgjegjësit e mësimdhënësve mentorë në zhvillimin e mësimdhënësve mentorë në zhvillimin e mësimdhënësve të rinj</li> <li>- Identifikojnë kompetencat e domosdoshme të një mentori të mire</li> <li>- Reflektojnë mbi procesin e mentorimit të studentëve – mësimdhënësit dhe modalitetet se si mund të ndihmojnë studentët në një mënyrë më të mire</li> <li>- Demonstrojnë shkathtësi për të inkurajuar studentët të angazhohen në praktikat shkrimit reflektiv në funksion të përmirësimit të cilësisë</li> </ul>
Metodat e realizimit të programit:	Të ndryshme
Certifikimi:	Po
Data	20.03.2017

<b>Titulli i programit</b>	<b>TË NXËNIT LIDHUR ME MJEDISIN (NLM)</b>	
<b>Titulli i organizatës</b>	<b>USAID Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)</b>	
<b>Tipi i programit:</b>	<b>Plotësues</b>	
<b>Ofertuesi i programit:</b>	<b>Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)\MASHT</b>	
<b>Adresa:</b>	<b>Kompleksi i shkollës "Mileniumi i Tretë", rr."Isa Kastrati"p.n.</b>	
<b>E-mail:</b>	<b><a href="mailto:office@kec-ks.org">office@kec-ks.org</a></b>	
<b>Telefoni:</b>	<b>038/244257/ext.109</b>	
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	<b>108/14</b>	Riakreditohet për 5 vite
	<b>06.06.2014</b>	
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	<b>34 orë</b>	
<b>Përfituesit:</b>	Mësimdhënësit e lëndëve lidhur me mjedisin në shkollat e mesme të ulëta dhe të lartë të Kosovës, kryesisht: biologji, gjeografi, gjuhë amtare, edukate fizike, edukatë qytetare, etj.	
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	25-30 pjesëmarrës	
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<p>Qëllimi i kursit</p> <p>Të nxënit lidhur me mjedisin ka për qëllim të aftësojë mësimdhënësit e lëndëve të ndryshme që, përmes një qasje ndër lëndorë, të ngrisin vetëdijen e nxënësve, kolegëve, udhëheqjes së shkollës dhe të komunitetit për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në shkollë dhe më gjerë në kontekst dhe në funksion të jetësimit të qëllimeve ,parimeve dhe kompetencave të kurrikulës shtetërore.</p> <p>Ky kurs po ashtu synon të informoj mësimdhënësit e nxënësit të bëhen kritikë, të bëhen qytetarë aktive besojnë në bashkëpunim dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë, të ndërmarrin veprime duke u përpjekur të ndryshojnë gjërat në komunitetet e tyre dhe në mbarë botën.</p> <p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p> <p>Në përfundim të kursit, vijuesit do të në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Shqyrtojnë vendin e tyre në botën që po ndryshon, për të kuptuar se si veprimi i njeriut në një vend të caktuar ndikon në vendet e tjera.</li> <li>-Shqyrton vlerat dhe përgjegjësit e tyre në raport me njerëzit e tjerë, mjedisin dhe planetin e tyre</li> <li>-Vlerësojnë në mënyrë kritike se çka thonë qeveritë, bizneset dhe individët, se çfarë janë duke bërë për të plotësuar nevojat e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme.</li> <li>Të marrin parasysh nevojat e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme kur i bëjnë zgjedhjet e tyre.</li> <li>Të mendojnë me imagjinatën rreth asaj se çka mund të bëjnë individët për të zhvilluar një shoqëri më të informuar dhe një të ardhme më të qëndrueshëm.</li> <li>-Zbulojnë mënyra për të ndikuar në të tjerët, duke vepruar si faktorë ndryshues</li> <li>-Kuptojnë sfidat globale afatgjata, përfshirë edhe ndryshimet klimatike, pabarazinë, varfërinë dhe zhvillimin, dhe ti vlerësojnë mënyrat në të cilat këto çështje ndikojnë dhe ndryshojnë shoqërinë.</li> </ul>	

**Përmbajtja:**

**1.** Korniza e kurrikulës dhe vendi e roli i NLM-së në jetësimin e saj: Në këtë pjesë jepen shpjegimet e ndërlidhjet e duhura për të përshkruar funksionin ndër lëndor e ndërkurrikular të NLM dhe rolin e tij në jetësimin e kornizës së re të kurrikulumit të Kosovës të bazuar në kompetenca. Këtu përpunohet skema e madhe dhe struktura e përgjithshme e kursit: korniza e kurrikulës, përvoja të nxënësve tërheqës në klasë dhe bashkëpunimi me komunitetin. Po ashtu prezantohet edhe lista e kompetencave dhe ajo e shkathtësive prioritare të Programit të Arsimit Themelor.

**2.** Qëllimi i ditës së dytë të punëtorisë është që tu prezantohen pjesëmarrësve qasjet e reja të aktiviteteve për mësimdhënie dhe të nxënësve në nivel shkollor me theks në NLM. Pas që çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin janë të ndërlidhura me mjedisin rreth shkollës, mësimi jashtë klasës është pjesë e aktiviteteve të ditës së dytë. Këtu NLM-ja ndërlidhet me qasjet dhe metodat e reja të mësimdhënies dhe të nxënësve, përfshirë edhe aktivitete të përvoja mësimore jashtë klasës të strukturuar dhe të planifikuara mire. Kështu do të zbatohen disa aktivitete si: Metoda e hapësirës për Dialog dhe Hulumtim(HDH)

Tregu, Debatimi i heshtur dhe Mendimi Kritik dhe Hulumtimi i dukurive në lidhje me mjedisin.

**3.** Qëllimi i ditës së tretë është që tu jepet fasilitatorve një instrument i fuqishëm për të përpunuar një mënyrë të re të menduarit për NLM-në në kuadër të zhvillimit profesional. Pas kësaj, do të zhvillohet të menduarit e qartë në lidhje me begatimin e NLM-së, klubet e Gjelbra, partneritetet në komunitet, e të tjera, me qëllim që të merret parasysh rëndësia e krijimit të NLM-së aktiviteteve të qëndrueshme që lidhet me synimet arsimore dhe ato të shoqërisë civile. Këtu pjesëmarrësit e shohin se si NLM është një agjendë edukativo-arsimore që kërkon qasje nismëtare brenda shkollave tona. Në fund, ata do të kuptojnë se si klubet e Gjelbra dhe aktivitetet begatuese mund të zhvillohen në shkollat dhe të kenë ndikim tek komuniteti në të cilin është vendosur shkolla; njëkohësisht, do të shikojnë se si mund të punojnë së bashku shkollat dhe partneret nga komuniteti. Të gjitha këto janë në funksion të vendosjes së lidhjeve të qëndrueshme me veprime praktike të nxënësve dhe komunitetit me bërthamën e mësimdhënies dhe nxënies brenda kurrikulës së shkollës.

<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi:</b>	Po
<b>Trajnera:</b>	17
<b>Datë:</b>	30.04.2014

Titulli i Programit	TË NXËNIT PËRMES PROJEKTEVE NË SHKENCAT NATYRORE	
Titulli i organizatës	USAID Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)	
Tipi i programit:	BAZIK	
Ofertuesi i programit:	USAID \MASHT\Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)	
Adresa:	Kompleksi i shkollës "Mileniumi i Tretë", rr."Isa Kastrati", p.n.	
E-mail:	<a href="mailto:office@kec-ks.org">office@kec-ks.org</a>	
Telefoni:	038/244257/ext.109	
Numrat dhe data e akreditimit:	108/14 06.06.2014	Riakreditohet për 5 vite
Kohëzgjatja e programit (orë)	24 orë	
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkencave natyrore (kimi, fizikë, biologji) në shkollat fillore e të mesme të ulëta në Kosovë	
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25-30 pjesëmarrës	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p><u>Objektivat e kursit</u> Ngritja e vetëdijes së mësimdhënësve për qasjen e re të nxënimit në shkencat e natyrës, duke u bazuar në të nxënimit përmes projekteve; Promovimi i mësimdhënies me nxënësin në qendër; Përmirësimi i rezultateve mësimore në shkollat e mesme të ulëta; Aftësimi profesional i mësimdhënësve për zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies; Promovimi i mësimdhënies së bazuar në zhvillimin e shkathtësive të shekullit 21</p> <p><u>Rezultatet e të nxënimit</u> Pas përfundimit të kursit, vijues do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aplikojnë qasjen e re të nxënimit në shkencat e natyrës ,duke u bazuar në të nxënimit përmes projekteve,</li> <li>• Njohja me shkathtësitë relevante të BEP-it në kontekst të kornizës së kurrikulës së Kosovës</li> <li>• Identifikojnë ndërlidhjen e NPP në shkenca dhe kurrikulit të bazuar në kompetenca.</li> </ul>	
Përmbajtja:	<p>Në këtë kurs do të shqyrtohen temat vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidhja e kursit me kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe me shkathtësitë Relevante të Programit për Arsimin Themelor</li> <li>• Konstruktivizmi dhe shkathtësitë e shekullit 21-prezentim.</li> <li>• Është epidemik-Biologji-Aktivitet</li> <li>• Të mësuarit përmes zgjedhjes së problemeve-prezentim.keqbërsi me fytyrë të buzqeshur –Kimi dhe Fizikë –Aktivitet</li> <li>• Pakoja teknologjike shkencore</li> <li>• Të nxënimit përmes projekteve: Rënia e vezës-Fizikë-Aktivitet</li> <li>• Dizajnimi si process për të zgjedhur një problem relevant, autentik të jetës së përditshme. Veprimi i makinës së gjelbër-Aktiviteti.</li> </ul>	
Metodat e realizimit të programit:	Të ndryshme	
Certifikimi:	Po	
Data:	30.04.2014	
Trajner:	13	

Titulli i programit	UDHËHEQJA DHE MENAXHIMI I SHKOLLAVE
Titulli i organizatës	GIZ
Tipi i programit:	Bazik
Ofertuesi i programit:	GiZ\MASHT
Adresa:	Rr. "Anton Çeta", nr.1, 10000, Prishtinë, Kosovë
E-mail:	<a href="mailto:Dagmar.fuchs-schmitz@giz.de">Dagmar.fuchs-schmitz@giz.de</a>
Telefoni:	+381 (0) 38 233 002
Numrat dhe data e akreditimit:	158/16 Akreditohet për 3 vite 28.09.2016
Kohëzgjatja e programit (orë)	21 ditë trajnimi
Përfituesit:	Drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është që të ofrojë efikasitet dhe efektshmëri tek udhëheqja dhe menaxhmenti i shkollave në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit në përgjithësi.

Ekzistojnë 7 module dhe të gjitha modulet ndjekin të njëjtën strukturë: hyrjen, qëllimin e modulit si dhe përfundimin e pritur të modulit si pjesë e pare, i cili ndiqet nga teksti kryesor ku prezantohen dhe shpjegohen konceptet, qasja dhe instrumentet, duke përfshirë detyrat praktike për pjesëmarrësit. Pjesa përfundimtare e secilit modul përfshin referencat, fjalorthin si dhe shtojcat.

**Moduli 1: Cilësia e Arsimit –** Ky modul prezanton konceptin e cilësisë së arsimit në kontekstin ndërkombëtar dhe kombëtarë nënvizon marrëdhënien në mes të cilësisë së arsimit dhe rritjes ekonomike është nënvizuar gjithashtu edhe koncepti i monitorimit me bazë rezultatin dhe planifikimit me bazë të të dhënave.

**Moduli 2: Shkolla e mirë –** Shpjegohen fushat cilësore për zhvillimin e shkollave, duke u fokusuar në kulturën e të mësuarit, kulturën e shkollës dhe nevojën për një strategji dhe vision të zhvillimit të cilësisë në aspektin afatgjatë dhe afatmesëm.

**Moduli 3: Plani zhvillimor i shkollës –** Ky modul ofron një qasje të strukturuar për të shtjelluar planin për zhvillim të shkollave. Formatu PZSH mbështet këtë proces duke ofruar një strukturë për hapat e njëpasnjëshëm që janë të nevojshëm për të identifikuar projektet primare për vitin e radhës.

**Moduli 4: Menaxhimi i projektit –** Prezantohen konceptet themelore në lidhje me projektin dhe menaxhmentin. Faza e inicimit, planifikimit, ekzekutimit dhe vlerësimit të projekteve shpjegohen në bazë të Menaxhimit të Ciklit të Projektit (PCM).

**Moduli 5: Komunikimi dhe Bashkëpunimi –** Komunikimi në një shkollë përshkruhet në detaje: me dhe në mes të arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve. Janë prezantuar baza ligjore, përbërja dhe roli i organizmave të ndryshëm të shkollës siç janë Këshilli dhe Bordi Menaxhues i shkollës.

**Moduli 6: Udhëheqësia dhe Administrimi i Personelit –** Prezantohen disa lloje të udhëheqëses tema e delegimit shpjegohet në detaje. Nevojat për zhvillim sistematik të stafit, bazuar në vlerësim individual, shpjegohen për stafin jo-mësimor dhe mësimor.

**Moduli 7: Administrimi efektiv i shkollës dhe udhëheqja e takimeve –** Moduli mbi administratën në shkollë fokusohet në menaxhimin e kohës, dokumenteve dhe takimeve.

#### Përmbajtja:

<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi:</b>	Po
<b>Trajner:</b>	7
<b>Data:</b>	28.06.2016

UDHËZUES PËR ZBATIMIM E KURRIKULËS	
Titulli i organizatës	MASHT-së
Tipi i programit:	Bazik
Ofertuesi i programit:	MASHT-së
Adresa:	Rruga "Agim Ramadani"pa numer
E-mail:	<a href="mailto:lgballe.cakaj@rks-gov.net">lgballe.cakaj@rks-gov.net</a>
Telefoni:	038 213 005
Numrat dhe data e akreditimit:	Udhëzuesit janë të miratuar nga MASHT-së për zbatimin e Kurrikules së re të Kosovës
Kohëzgjatja e programit (orë)	40 orë -5 ditë me bazë në shkollë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e klasës përgaditore dhe arsimit fillor, të mesëm të ultë dhe arsimit të mesëm të lartë
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25-30 pjesmarrës
UDHËZUSIT E FUSHAVE KURRIKULARE:	1.GJUHË DHE KOMUNIKIM 2.ARTET 3.MATEMATIKA 4.SHKENCAT E NATYRËS 5. SHOQËRIA DHE MJEDISI 6.JETA DHE PUNA 7.EDUKATË FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI
Rëndësia e udhëzuesit	Udhëzuesi mbështet zbatueshmërinë e KK-së, respektivisht KB-ve dhe programeve lëndore, në gjithë arsimin parauniversitar. Shembujt e modeleve praktike të planifikimeve mësimore, të metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, ndihmojnë ndërlidhjen e kurrikulës me proceset e mësimin në shkollë.
Qëllimi i udhëzuesit	Meqenëse mësimdhënësit janë bartësit kryesorë të zbatimit të filozofisë së KK,-së udhëzuesi ka për qëllim ndihmesën, sqarimin dhe udhëzimin e mësimdhënësve për të kuptuar dhe zbërthyer KK-në, KB-të dhe programet mësimore, lëndore, për secilën klasë. Për t'i udhëzuar atapër planifikime mësimore, për zgjedhjen e strategjive dhe teknikave të mësimdhënies të të nxënësve dhe të vlerësimit të arritshmërive të nxënësve si dhe në vetëvlerësimin e procesit mësimor. Në këtë mënyrë ndihmohet në zhvillimin e kompetencave të caktuara të nxënësve, sipas shkallëve të kurrikulës.
Përdorimidhe përdoruesite udhëzuesit	Udhëzuesi në fillim përdoret si material trajnues i mësimdhënësve për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale të mësimdhënësve në zbatimin e KK-së, respektivisht të KB dhe programeve lëndore në sistemin parauniversitar. Në të ardhmen llogaritet që ky udhëzues krahas me Ëudhëzues të tjerë, t`ju shërbejë mësimdhënësve gjatë punës së pavarur në realizimin e kurrikulës së re .

çështjet që trajtohen në udhëzues dhe strategjitë që praktikohen gjatë trajnimit, bëjnë që mësime të arrijë këto rezultate:

**Rezultatet e pritura nga përdorimi i udhëzuesit**

- Identifikon qasjet për të arritur qëllimet e arsimit të përcaktuara me KK;
- Identifikon qasjet për të respektuar parimet e KK-së në procesin arsimor, duke përfshirë planifikimet, metodologjitë dhe vlerësimin;
- Identifikon elementet e domosdoshme të përmbajtjes së planifikimeve mësimore për zbatimin e KB-ve dhe programeve mësimore;
- Realizon modele të planifikimeve mësimore në të cilat përfshihen elementet e domosdoshme të KB-ve dhe programeve mësimore;
- Realizon modele të strategjive të mësimit dhe të të nxënësve, duke respektuar parimet e KK-së;
- Realizon modele të përgatitjes dhe shfrytëzimit të materialeve mësimore;
- Zbaton strategji, teknika dhe instrumente të vlerësimit konform parimeve të kurrikulës dhe specifikeve të programeve mësimore;
- Zbaton strategji të bashkëpunimit kolegjial brenda dhe jashtë shkollës, si kurorëzim i suksesit të shkollës.



Udhëzuesi përbëhet prej shtatë kapitujve dhe shtojcës. Në secilin kapitull elaborohen çështje që u ndihmojnë mësimdhënësve të kuptojnë ecurinë e zërthimit të KK-së, të KB-ve dhe programeve mësimore në sistemin para universitar në praktikën shkollore.

**Në kapitullin e parë – Hyrja**, trajtohet rëndësia e udhëzuesit, qëllimi i udhëzuesit, përdorimi dhe përdoruesit e udhëzuesit, rezultatet e pritura nga përdoruesit e udhëzuesit dhe organizimi i udhëzuesit.

**Në kapitullin e dytë - Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula Bërthamë – zbatimi në praktikë**, trajtohen çështje që ndihmojnë jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, respektimin e parimeve të kurrikulës në procesin e arsimit në shkollë, kuptimin e zërthyeshmërisë së rezultateve të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës dhe për fusha kurrikulare e programe mësimore lëndore në planifikime mësimore.

**Në Kapitullin e tretë – Programet mësimore**, trajtohet qëllimi i programeve mësimore, lidhja e programeve mësimore me konceptet e fushës dhe me rezultatet e të nxënësve të fushës, temat dhe rezultatet e të nxënësve, udhëzimet metodologjike në programet mësimore.

**Në Kapitullin e katërt - Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re**, trajtohen çështje të planifikimeve mësimore, duke integruar elemente të domosdoshme të KB-së dhe programeve mësimore, çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare e programeve mësimore dhe bashkëpunimi kolegjial në funksion të zbatimit të KB-së dhe programeve mësimore.

**Në kapitullin e pestë – Kurrikula me zgjedhje** – zbatimi në praktikë, trajtohen aspektet që do të ndihmojnë shkollën në konceptimin e drejtë të të kuptuarit të kurrikulës me zgjedhje si pjesë përbërëse e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, në dhënien e udhëzimeve për hartimin e tij, në konkretizimin e procedurave dhe të kritereve për miratimin e realizimin e tij dhe në paraqitjen e modeleve të caktuara të cilat do të shërbejnë për cilësi të të gjitha aspekteve që ndërlidhen me kurrikulën me zgjedhje.

**Në kapitullin e gjashtë – Metodologjia e mësimdhënies dhe materialet mësimore**, trajtohen strategji të mësimdhënies dhe të të nxënësve, duke përfshirë metoda, teknika të mësimdhënies dhe të të nxënësve të suksesshëm, përgatitje dhe shfrytëzim të materialeve mësimore.

**Në kapitullin e shtatë – Vlerësimi i nxënësve - Qasjet praktike në vlerësimin e nxënësve**, trajtohen metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, respektivisht kompetencat, rezultatet e të nxënësve dhe nivelet e njohjes në funksion të vlerësimit.

**Shtojcat** - përmban instrumente të planifikimeve dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, të përgatitura nga mësimdhënësit.

#### Organizimi i udhëzuesit

Certifikimi	I bazuar në bazë të rezultateve të treguara
Data	Janr 2017
Trajner	76

<b>Titulli i programit</b>	<b>VLERËSIMI I LEXIMIT NË KLASAT E ULËTA (EGRA)</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	USAID
<b>Tipi i programit:</b>	BAZIK
<b>Ofertuesi i programit:</b>	Bsic Edukation Program \QAK
<b>Adresa:</b>	Kompleksi i shkollës "Mileniumi i tretë", rr. "Isa Kastrati", p.n.
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:bepinfo@fhi360.org">bepinfo@fhi360.org</a>
<b>Telefoni:</b>	038 258 301
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	157/2016 Riakreditohet për 3 vite 28.09.2016
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	20 orë
<b>Përfituesit:</b>	Nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta: mësimdhënës, drejtorë, prindër dhe komuniteti i gjerë
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	25 pjesëmarrës
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<p><b>Qëllimet e kursit</b></p> <p>Programi Vlerësimi i leximit në klasat e ulëta - EGRA që zhvillohet në kuadër të komponentës "Përmirësimi i vlerësimit të rezultateve të të nxënësve "ka për qëllim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillojë vetëdijësimin e mësimdhënësve për rëndësinë e vlerësimit të leximit në klasat e ulëta;</li> <li>- Aftësojë mësimdhënësit për zbatimin e testit EGRA për identifikimin e nevojave për intervenim;</li> <li>- Të përmirësojë rezultatet mësimore në shkollat fillore në lidhje me leximin;</li> <li>- <b>Rezultatet e të nxënësve</b></li> <li>- Pas përfundimit të kursit vijuesit do të jenë në gjendje të:</li> <li>- Kuptojnë nevojën për zbatimin e testit EGRA</li> <li>- Administrojnë testin EGRA</li> <li>- Identifikojnë nxënësit që kanë nevojë për përmirësim të shkathhtësisë të leximit</li> <li>- Dallojnë nevojat specifike të nxënësve</li> <li>- Zbatojnë strategji për përmirësim të leximit</li> </ul>
<b>Përmbajtja:</b>	<p>Programi Vlerësimi i leximit në klasat e ulëta (EGRA) shqyrton nivelin e njohurive të nxënësve në lexim në klasat e para të nivelit fillor. Programi merret me vlerësimin e nivelit të nxënësve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuri fonetike</li> <li>• Njohuri tingllore</li> <li>• Fjalët e njohura</li> <li>• Fjalët pa kuptim</li> <li>• Rrjedhshmëri në lexim</li> <li>• Të kuptuarit përmes leximit</li> <li>• Të kuptuarit përmes dëgjimit</li> <li>• Diktim</li> </ul> <p>Programi gjithashtu identifikon nevojat për përmirësim të njohurive të nxënësve në aspekteve të ndryshme të leximit. E gjithë kjo gërshetohet me ide dhe strategji të ndryshme për zbatim.</p> <p>Në përgjithësi, programi shqyrton vlerësimin e leximit në klasat e ulëta si një proces të vëzhgimit sistematik që siguron një kuptim më të mirë të asaj se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe si do të angazhohen ata thellësisht në procesin e të nxënësve për të përmirësuar të arriturat e tyre në mënyrë të vazhdueshme.</p>
<b>Metodat e realizimit të programit</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi</b>	Po
<b>Data</b>	18.09.2015
<b>Trajneret</b>	8

<b>Titulli i programit</b>	<b>VLERËSIMI PËRMBLEDHËS DHE HARTIMI I TESTIT SI PJESË E RËNDËSISHME E TIJ (KLASAT 1-9)</b>
<b>Titulli i organizatës</b>	GIZ
<b>Tipi i programit:</b>	Bazik
<b>Ofertuesi i programit:</b>	GIZ/MASHT
<b>Adresa:</b>	Rr. "Anton Çeta", nr.1, 10000, Prishtinë, Kosovë
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:Dagmar.fuchs-schmitz@giz.de">Dagmar.fuchs-schmitz@giz.de</a>
<b>Telefoni:</b>	+381 (0) 38 233 002
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	159/16 Akreditohet për 5 vite 28.09.2016
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	30 orë.
<b>Përfituesit:</b>	Ky program i dedikohet mësimeve të klasave 1-9 në fushën e matematikës dhe të shkencave të natyrës, por nga i njëjti mund të përfitojnë edhe mësuesit e lëndëve dhe fushave tjera që kanë interes për të avancuar në hartimin e testeve në këtë nivel shkollimi. Programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët, të cilët janë duke u përgatitur si mësues të ardhshëm.
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	15-25 pjesëmarrës
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<p>Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njihen me vlerësimin përmbledhës, llojet e format kryesore të tij dhe rëndësinë që ai ka për vlerësimin e njohurive dhe kompetencave të fituara,</li> <li>- Të njihen me testin si formë kryesore e vlerësimit përmbledhës dhe me treguesit e testit,</li> <li>- Të njihen dhe aftësohen të përdorin procedurat standarde të hartimit të një testi për vlerësim përmbledhës</li> <li>- Të hartojnë teste vlerësuese duke dalluar nivelet sipas taksonomisë së Blumit,</li> <li>- Të ndërtojnë strukturën e tekstit – tabelën e specifikimeve të testit</li> <li>- Të njihen dhe aftësohen që të përmirësojnë të shkruarit e pyetjeve të formateve të ndryshme</li> <li>- Të realizojnë, për të njëjtën kërkesë/ pyetje, kalimin nga një nivel taksonomie në një tjetër.</li> <li>- Të njihen dhe aftësohen të matin treguesit kryesorë të pyetjeve në përbërjes të një testi përmbledhës</li> <li>- Të bëjnë lidhjen ndërmjet rezultateve mësimore për fushë me kompetencat e përshkruara për shkallë të kurrikulës</li> <li>- Të realizojnë një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të besueshëm</li> <li>- Të aftësohen të zbatojnë vlerësimin përmbledhës në punën e tyre</li> </ul>

Përmbajtja:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Llojet e vlerësimeve të nxënësve dhe roli i vlerësimit përmbledhës në procesin e mësimdhënies.</b> – format dhe parimet e vlerësimit. Aspektet e përgjithshme kulturore dhe gjuhësore të përmbajtjes.</li> <li>2. <b>Zhvillimi i testit dhe lidhja e pyetjeve/kërkesave me rezultatet e të nxënësve për fushë dhe kompetenca për shkallë.</b> – Tabelar e testit, procedurat standard të hartimit të një testi, pikëzimi dhe kthimi i pikëve në notë. Hartimi i pyetjeve sipas Taksonomisë së Blumit për nivelet e dijes, përmirësimi i pyetjeve, përmbajtja e testit. Llojet e pyetjeve, udhëzime të të shkruarit të pyetjeve, pyetjet me prezantim grafik, pyetjet me përgjigje të strukturuar, rregullat e shkrimit të tyre. Problemet, struktura e zgjidhjes së tyre. Hartimi i pyetjeve/kërkesave dhe lidhja e tyre me rezultatet e të nxënësve për fushë dhe kompetencën për shkallë.</li> <li>3. <b>Analiza e testit/pyetjeve.</b> – Analiza e pyetjeve, vështirësia e pyetjes, diskriminimi i pyetjes, shpeshtësia e alternatives.</li> </ol>
<b>Metodat e realizimit të programit</b>	
<b>Certifikimi</b>	
<b>Data</b>	22.04.2015
<b>Trajner</b>	24

<b>Titulli i Programit</b>	<b>ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË LEXIMIT NË KLASAT E HERSHME</b>	
<b>Titulli i organizatës</b>	USAID Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)	
<b>Tipi i programit:</b>	Bazik	
<b>Ofertuesi i programit:</b>	QAK\MASHT	
<b>Adresa:</b>	Kompleksi i shkollës "Mileniumi i Tretë", rr."Isa Kastrati", p.n.	
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:office@kec-ks.org">office@kec-ks.org</a>	
<b>Telefoni:</b>	038/244257/ext.109	
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	134/2015 21.12.2015	Riakreditohet për 3 vite
<b>Kohëzgjatja e programit (orë)</b>	24 orë	
<b>Përfutuesit:</b>	Mësimdhënësit e shkollave fillore (niveli 1-5)	
<b>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</b>	25-30 pjesëmarrës	
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Qëllimet e kursit</b></li> <li>- Tu ofrohet mësimdhënësve të shkollës fillore një program pune që fokusohet në zbatimin e teknikave dhe strategjive për të përmirësuar shkathtësitë e shkrim-leximit të nxënësit e klasave të hershme.</li> <li>- <b>Rezultatet e të nxënësve</b></li> <li>- <b>Të kuptojnë fazat e zhvillimit të shkathtësive të shkrim-leximit të fëmijëve të fëmijëve të moshave të reja;</b></li> <li>- <b>Të dallojnë komponentët e shkrim –leximit dhe t'i lidhin atone procesin e zhvillimit të shkathtësve gjuhësore të nxënësit;</b></li> <li>- <b>Të përvetësojnë strategjit dhe teknikat për ngritjen e shkathtësive të nxënësve për vetëdijen fonemike, fonetikën, degjim-kuptimin, lexim-kuptimin, rrjedhmerin dhe fjalorin ;</b></li> <li>- <b>Të identifikojnë llojet e vështërsive që nxënësit hasin në lexim dhe të përvetësojnë strategji për tu ndihmuar atyre nxënësve;</b></li> <li>- <b>Të praktikojnë teknika të krijimit të librave, për të ushqyer shkathtësitë e të shkruarit të nxënësit;</b></li> <li>- <b>Të demonstrojnë shkathtësi për të analizuar aspektet gjinore dhe koherencën shoqërore në tekstet shkollore dhe librat tjerë për fëmijë;</b></li> <li>- <b>Të analizojnë mënyra të ndryshme për angazhimin e prindërve në zhvillimin e shkathtësive të shkrim-leximit të fëmijëve të tyre.</b></li> </ul>	
<b>Përmbajtja:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në këtë kurs do të shqyrtohen temat vijuese:</li> <li>- Shikimi i përgjithëm për shkrim lexim</li> <li>- Vlerësimi i leximit në klasat e hershme</li> <li>- Dëgjim-kuptimi</li> <li>- Vetëdija fonetike/tingëllore</li> <li>- Fonetika</li> <li>- Rrjedhshmëria</li> <li>- Fjalori</li> <li>- Lexim-kuptim</li> <li>- Të shkruarit</li> <li>- Nxënësit me vështirësi në të lexuar</li> <li>- Aspektet gjinore në literature</li> <li>- Përfshirja e prindërve</li> </ul>	
<b>Metodat e realizimit të programit</b>	Të ndryshme	
<b>Certifikimi</b>	Po	
<b>Trajner</b>	6	
<b>Data</b>	31.03.2015	

<b>Titulli i Programit</b>	<b>ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË SHEKULLIT 21 NË LËNDËN E MATEMATIKËS</b>	
<b>Titulli i organizates</b>	<b>USAID - Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)</b>	
<b>Tipi i programit:</b>	Bazik	
<b>Ofertuesi i programit:</b>	<b>Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)</b>	
<b>Adresa:</b>	Kompleksi i shkollës "Mileniumi i Tretë", rr."Isa Kastrati", p.n.	
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:office@kec-ks.org">office@kec-ks.org</a>	
<b>Telefoni:</b>	038/244257/ext.109	
<b>Numrat dhe data e akreditimit:</b>	126/2015 29.06.2015	Riakreditohet për 5 vite
<b>Kokëzgjatja e programit (orë):</b>	24 orë	
<b>Përfituesit:</b>	Mësimdhënësit klasor të shkollave fillore dhe arsimtarët e matematikës në shkollat e mesme të ulëta	
<b>Numri optimal i pjesmarrësve në trajnim:</b>		
<b>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</b>	<p>Qëllimet e kursit :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptuarit e matematikës si shkencë e modeleve dhe raporteve dhe si një shkencë që zbatohet në situata të ndryshme në jetën e përditshme</li> <li>- Ngritja e vetëdijës për qasjet, burimet dhe teknologjit e reja në mësimdhënien e matematikës</li> <li>- Paraqitja e rolit të hulumtimeve matematikore në zhvillimin e shkathhtësive të shek. XXI siq janë: zgjedhja e problemeve, puna ekipore, të menduarit kritik dhe TIK-u në mesin e nxënësve tuaj.</li> <li>- Ofrimi i ideve praktike për tu përdorur në orët e matematikës</li> <li>- Përmirësimi i arritjeve të nxënësve në matematikë.</li> <li>- Rezultatet e të nxënësve</li> <li>- Pas përfundimit të kursit, vijuesit do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë procesin e hulumtimit në matematikë</li> <li>- Kuptojnë strategjitë sipas Polyas për zgjedhjen e problemeve</li> <li>- Kuptojnë për hulumtimet e reja në lidhje me zhvillimin e fëmijëve dhe zhvillimin e trurit</li> <li>- Organizojnë probleme praktike në klasat e tyre.</li> <li>- Shpjegojnë konceptet matematikore nëpërmjet shembujve konkretë nga përditshmëria jonë</li> <li>- Mësojnë disa lojra që mund të ndërlidhen me njësitet përkatëse nga matematika</li> <li>- Njihen me punën e kalkulatorit dhe programeve kompjuterike (Geogebra, EXCEL, Logo)</li> <li>- Njihen me disa burime të rëndësishme në internet.</li> <li>- Kërkojnë, përmes makinave të kërkimit, për burime të tjera të informacionit, e që lidhen drejtëpërdrejtë me punën e tyre të përditshme në shkollë.</li> </ul> </li> </ul>	

Përmbajtja:	<p><b>1.Hyrje</b> Kompetencat krzesore të kurikulës së re dhe shkathtësitë e shekullit 21.</p> <p><b>2. Çka është matematika:</b> Disa sfera të përditshme jetësore në të cilat gjen zbatim matematika, dhe strategjit e problemeve sipas Polyas</p> <p><b>3.Matematika Moderne dhe Shiriti i Mobiusit:</b> Aktivitetet praktike përmes të cilit shihet rëndësia e hulumtimit të modeleve matematikore përmes mjeteve të thjeshta dhe atyre nga nga jeta e përditshme.</p> <p><b>4.Nxënësit menevoja të veçanta arsimore dhe fjalori i matematikës:</b> Prezentimi i intelgjencave të shumëfishta dhe të mësuerit e matematikës. Formimi i një fjalori të matematikës si mjet i rëndësishëm për të mësuar matematikën.</p> <p><b>5.Numrat (1-5) dhe (6-9)</b> Zhvilimi i aftësive për zgjedhjen e problemeve të ndryshme përmes përdorimit të numrave.</p> <p><b>6.Matematika në jetën reale dhe lojërat:</b> Ndërlidhja e matematikës me jetën e përditëshme të nxënësve për të kuptuar matematikën</p> <p><b>7.Kalkulatorët dhe përdorimi i tyre:</b> Zbatimi i kalkulatorëve në matematikë.</p> <p><b>8.Puna me projekte dhe Excel:</b> Aktivitetet shtesë-aktivitete praktike</p> <p><b>9.Geogebra dhe FMS Logo</b></p> <p><b>10.Përdorimi i kompjuterit dhe burimet në internet:</b> Njohja me programe të ndryshme kompjuterike, përdorimi i internetit dhe ndërlidhja e tyre me matematikën.</p>
<b>Metodat e realizimit të programit:</b>	Të ndryshme
<b>Certifikimi:</b>	Po
<b>Data:</b>	31.03.2015
<b>Trajneretë:</b>	5

